

LIGJ
Nr.7381, datë 9.5.1990

PËR KRIJIMIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË

Duke marrë parasysh nevojat që shtrun zhvillimi i vendit për thellimin e demokracisë socialiste dhe përsosjen e mëtejshme të legjislacionit e të sistemit të organeve shtetërore, si dhe për forcimin e vazhdueshëm të ligjshmërisë socialiste,

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Krijimin e Ministrisë së Drejtësisë me këto kompetenca:

a) Kujdeset për organizimin dhe funksionimin e gjykatave të rretheve e të zonave, si dhe të avokatisë.

b) Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës gjyqësore, zyrën e gjendjes gjyqësore, përmbarimin, noterinë dhe zyrat e regjistrimit të pronësisë së ndërtesave vetjake për banim; administron veprimtarinë e shërbimit unik statistikor të organeve gjyqësore, të hetuesisë, të prokurorisë e të arbitrazhit shtetëror.

c) Vepron si organ qendror i specializuar për rishikimin dhe përsosjen e legjislacionit. Përgatit projektet e kodeve, të ligjeve e të dekreteve, të vendimeve e të urdhërësave të Këshillit të Ministrave për çështje që kanë të bëjnë me organizimin dhe veprimtarinë e organeve gjyqësore, shoh legjitimitetin dhe shfaq mendim për projektet e kodeve, të ligjeve e të dekreteve, të vendimeve e të urdhërësave të tjera.

ç) Bashkërendon veprimtarinë e organeve gjyqësore, të prokurorisë, të hetuesisë, të avokatisë e të administratës shtetërore për propagandimin e ligjeve.

d) Drejton punën për kualifikimin e jursitëve të gjykatave të rretheve e të zonave, të avokatisë dhe të organeve të administratës shetërore.

dh) Drejton metodologjikisht veprimtarinë e zyrave të gjendjes civile.

e) Drejton shërbimin kriminalistik dhe të mjekësisë ligjore.

f) Përfaqëson vendin tonë në marrëdhëniet me organizatat juridike ndërkombëtare.

Neni 2

Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave ngarkohet të nxjerrë vendimin përkatës.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nenet 29-38 të dekretit nr.7174, datë 20.11.1987 "Për organizimin gjyqësor të RPSSH", si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA